



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 19 dhe 20 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016, Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer 15Nr.400-33781 i datës 29.06.2017, Vendimit të Kryetarit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e fermerëve të Komunës së Lipjanit 1Nr.400-38442 i datës 19.07.2017, Rekomandimit të Komisionit - aktit mbi shpalljen e listës përfundimtare të përfituesve të serrave pas shqyrtimit të ankesave Nr.12-320-38359 të datës 04.12.2017 si dhe Rekomandimit të Komisionit të datës 03.01.2018, Kryetari i Komunes nxjerr:

VENDIM
PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR NDARJEN E SERRAVE 1Nr.320-64862 TË DATËS
06.12.2017

I. Me këtë Vendim ndryshohet neni 1 i Vendimit për ndarjen e serrave 1Nr.320-64862 të datës 06.12.2017, në pjesën tabelare të përfituesit e serrave ashtu që:

- a. Përfituesi Xhavit Agushi nga Gadimja e Epërme në numrin rendor 8 fshihet nga lista përfundimtare.
- b. Përfituesi Bajrush Ismajli nga Gadimja e Epërme në numrin rendor fshihet nga lista përfundimtare

II. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Ndryshimi i Vendimit të cekur bëhet bazuar në Rekomandimin e Komisionit i datës 03.01.2018 përshkak se gjatë zbatimit praktik të Vendimit për ndarjen e serrave (shpërndarjes së serrave) është vërtetuar se përfituesi i parë jeton në shtetet e Evropës ndërsa përfituesi i dytë është i vdekur . Nga të cekurat më lartë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të lartëcekurit nuk do të jenë përfitues të serrave pasi u vendos si në dispozitiv të pikes I të këtij Vendimi.

Vendimi dërgohet:

Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Kryesuesit të Komisionit- Pajtim Krasniqi

1Nr. 320-38359/3

Lipjan, më 24.01.2018

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

